

Banka e Shqipërisë

LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË 2019

Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë.

TETOR 2020

PËRMBAJTJA

1	<i>HYRJË</i>	4
2	<i>Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorëve institucionalë</i>	6
3	<i>Ndërlidhja financiare e sektorëve institucionalë</i>	8
4	<i>Zhvillimet sipas sektorëve institucionalë</i>	10
	<i>Ekonomitë familjare</i>	10
	<i>Korporatat jofinanciare</i>	12
	<i>Qeveria e përgjithshme</i>	14
	<i>Korporatat financiare</i>	16
	<i>Korporata depozituese përveç bankës qendrore</i>	19
	<i>Fondet e investimeve</i>	19
	<i>Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit</i>	20

1 HYRJE

Llogaritë financiare janë një sistem statistikor i integruar, që pasqyron marrëdhëniet financiare ndërmjet sektorëve të ekonomisë. Ato japin një pamje të plotë dhe gjithëpërfshirëse të situatës financiare dhe marrëdhënieve financiare në ekonomi, përsa i përket sektorëve ekonomikë dhe instrumenteve financiare, përfshirë edhe marrëdhëniet me jorezidentët. Llogaritë financiare ofrojnë një tablo mbi operacionet dhe strukturën e sistemit financiar duke identifikuar kanalet kryesore të përdorura për të përfutur dhe investuar burimet financiare.

Llogaritë financiare janë pjesë e llogarive kombëtare dhe hartohen në përputhje me metodologjinë e sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale (ESA 2010). Manuali ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) është një standard ndërkombëtar që shërben për hartimin e statistikave të llogarive kombëtare, për të gjitha vendet në Evropë¹.

Një nga rezultatet kryesore të llogarive financiare konsiston në llogaritjen e kursimit financiar në sektorë të ndryshëm institucionalë të ekonomisë, dmth diferenca midis investimit në mjete financiare në një periudhë të caktuar dhe detyrimeve të marra në të njëjtën periudhë. Përvetësimi i mjeteve financiare dhe emetimi i detyrimeve në sektorë të caktuar janë të barasvlefshëm me kapacitetin e huadhënies ose kërkesës së huamarrjes që buron nga aktiviteti ekonomik në të njëjtin sektor gjatë të njëjtës periudhë.

Si një statistikë sintezë, llogaritë financiare përdorin si burim të dhënash dy blloqe të rëndësishme statistikore të Bankës së Shqipërisë: statistikave monetare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë bashkëpunon ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në maksimizimin e përdorimit të të dhënave administrative.

Materiali në vijim, në seksionin e dytë prezanton situatën e Llogarive Financiare në vitin 2019 dhe ecurinë e tyre në vite. Seksioni i tretë ndalet në lidhjen ndërmjet sektorëve institucionalë dhe seksioni i katërt paraqet situatën e mjeteve financiare dhe të detyrimeve për çdo sektor të ekonomisë së vendit, pjesë e bllokut të llogarive financiare.

Banka e Shqipërisë publikon statistikave të Llogarive Financiare të Shqipërisë në faqen zyrtare të internetit, në seksionin Statistikave/Llogaritë Financiare/Aneks Statistikor. Shënimet metodologjike për hartimin e llogarive financiare gjenden gjithashtu të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Informacioni statistikor publikohet i detajuar për secilin sektor dhe nënsektor të ekonomisë në seri kohore 2013-2019.

¹ Për më gjerësisht, shpjegimi në botimin e Bankës së Shqipërisë "Statistikave të Llogarive Financiare për vitin 2017" dhjetor 2018, në seksionin 1 Kuadri metodologjik.

KOMENTE TË PËRGJITHSHME PËR LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË

Sistemi i llogarive kombëtare i klasifikon njësitë² institucionale në bazë të aktivitetit kryesor ekonomik dhe sipas rolit që luajnë në ekonominë e vendit. Sektorë institucionalë janë: korporatat jofinanciare, korporatat financiare, qeveria e përgjithshme dhe ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi.

Korporatat jofinanciare dhe korporatat financiare përfshijnë njëkohësisht korporatat private dhe ato publike (me akisone të zotëruara nga qeveria).

Qeveria e përgjithshme përfshin ato njësi institucionale, të cilat janë prodhues jotregu ose të cilat kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare dhe ku më shumë se 50% e aktivitetit të tyre financohet nga buxheti i qeverisë. Sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga tre nënsektorë: qeveria qendrore, qeveria lokale dhe fondet e sigurimeve shoqërore.

Sektori ekonomive familjare përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Në sektorin e institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve përfshihen njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.

Mjetet financiare dhe detyrimet klasifikohen në instrumentet financiarë: monedha dhe depozitat, letrat me vlerë të borxhit, hua, kapitali dhe aksionet në fonde investimi, sigurime dhe skemat e pensioneve, derivativë financiarë dhe llogari të tjera të arkëtueshme/të pagueshme. Dy instrumenta të tjerë, ari monetar dhe mbajtjet e SDR shfaqen vetëm në sektorin e korporatave financiare në nënsektorin e bankës qendrore.

² Një njësi institucionale karakterizohet nga autonomia e vendimarrjes në çështjet ekonomike, ku ose ruan një strukturë të plotë të llogarive ose është në gjendje të përpilojë një të tillë. Duhet të theksohet se koncepti themelor i ndarjes së ekonomisë në sektorë institucionalë sipas ESA 2010 ndryshon nga ai i klasifikimit të njësisve ekonomike prodhuese sipas NACE (Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike).

2 MJETET DHE DETYRIMET FINANCIARE TË SEKTORËVE INSTITUCIONALE

Grafiku 1 dhe tabela 1 prezantojnë llogaritë financiare të Shqipërisë në vitin 2019, të paraqitura në mjete financiare dhe detyrime të sektorëve institucionalë, të detajuara në instrumenta financiarë.

Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorit të korporatave financiare paraqiten në volume të konsiderueshme krahasimisht me ato të sektorëve të tjerë. Kjo për shkak se institucionet e përfshira në këtë sektor veprojnë si ndërmjetës financiarë. Pozicionet me jashtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të korporatave financiare.

Për sektorin e korporatave financiare, niveli i mjeteve financiare dhe detyrimeve është pothuajse i balancuar. Ndryshe paraqitet situata e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare. Për ekonomitë familjare, mjetet financiare në thelb tejkalojnë detyrimet, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të investimeve në formën e depozitave si dhe investimeve në formën e pjesëmarrjeve në kapitalin e korporatave jofinanciare. Në të njëjtën kohë, pretendimet ndaj korporatave të sigurimit dhe fondeve të pensionit, që rrjedhin nga skemat e pensioneve profesionale, përfshihen në mjete financiare të sektorit të ekonomive financiare (individët).

Për korporatat jofinanciare, detyrimet tejkalojnë pasuritë financiare në mënyrë të konsiderueshme. Kjo për faktin se: së pari, krahas kredive dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë gjithashtu vlerën e tregut të aksioneve të emetuara nga korporatat; dhe së dyti, mjetet jofinanciare të korporatave të financuara nëpërmjet kapitalit dhe kapitalit të huazuar nuk raportohen në llogaritë financiare. Më tej, paraqitja e të dhënave në llogaritë financiare bëhet në baza të pakonsoliduara, d.m.th. mjetet financiare dhe detyrimet brenda një sektori nuk netohen përkundrejt njëri-tjetrit, dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e korporatave jofinanciare.


Krahasimisht me vullumin monetar të sektorëve të tjerë, mjetet financiare dhe detyrimet e sektorit të qeverisë së përgjithshme janë të ulëta.

Totali i mjeteve financiare të sektorëve të brendshëm të ekonomisë (sektorëve rezidentë), në vitin 2019, vlerësohet në 5991 miliardë lekë, në rritje vjetore me 7.5%. Totali i detyrimeve u zgjerua me 7.3% në terma vjetorë, në nivelin 6,813 miliardë lekë. Në dimensionin e ekspozimit neto³, ekonomia shqiptare në fund të vitit 2018 pozicionohet në huamarrës neto me rreth -822 miliardë lekë. Ky nivel është rreth 6.3% më i lartë krahasuar me pozicionin prej -773 miliardë lekë në vitin 2018.

Seksioni 4 në vijim, ofron një tablo më të detajuar mbi zhvillimet në mjete dhe detyrime financiare të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

³ Diferenca mes mjeteve dhe detyrimeve financiare.

Grafik 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2019



Burimi: BSH

Tabelë 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2019
Në miliardë lekë

	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare
Mjete financiare				
Ari monetar dhe SDR	-	24	-	-
Monedha dhe depozita	258	558	57	1,085
Letra me vlerë të borxhit	28	827	0	86
Hua	68	687	59	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	84	34	225	699
Sigurime dhe skemat e pensioneve	20	9	..	5
Derivativë financiarë	..	0	0	..
Llogari të tjera të arkëtueshme	780	27	245	125
Totali	1,238	2,166	585	2,002
Detyrime				
Ari monetar dhe SDR	-	7	-	-
Monedha dhe depozita	-	1,721	-	-
Letra me vlerë të borxhit	33	8	640	-
Hua	679	97	399	224
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	1,467	292	-	0
Sigurime dhe skema pensioni	-	26	-	-
Derivativë financiarë	..	0	-	..
Llogari të tjera të pagueshme	890	22	297	12
Totali	3,069	2,173	1,335	236

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


..Mungon informacioni

Burimi: BSH

3 NDËRLIDHJA FINANCIARE E SEKTORËVE INSTITUCIONALE

Tradicionalisht, llogaritë financiare bazohen në një përfaqësim dy-dimensional, i përqendruar në sektorin institucional dhe në instrumentin financiar, dmth i secilit sektor institucional nga perspektiva e mjeteve dhe detyrimeve të tij financiare në instrumente të ndryshëm financiarë, pa identifikimin e palëve për të cilat këto mjete financiare / detyrime mbahen / kontraktohen. Për shembull, në paraqitjen dy-dimensionale të llogarive financiare, paraqiten vetëm pasuritë totale të ekonomisë familjare + NPISH në formën e investimeve në letra me vlerë, pa identifikuar se cilët janë sektorët që emetojnë ato letra me vlerë. Në këtë mënyrë, ky informacion nuk lejon një specifikim të hollësishëm të marrëdhënieve që krijohen midis sektorëve të ndryshëm nga kënvështrimi kreditor / debitor.

Ky seksion synon të analizojë modelet e financimit të vendosura midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si dhe mes tyre dhe “pjesës tjetër të botës” ose sektorit jorezident. Për këtë qëllim, informacioni mbi gjendjen financiare kombinohet me konceptin e rrjedhës së fondeve “nga kush-tek kush”⁴, në mënyrë të tillë që të mundësojë matjen e marrëdhënieve financiare ndërsektoriale në ekonominë shqiptare dhe shkallën e ndërveprimit të saj me botën (sektori jorezident). Grafiku 2 paraqet ndërlidhjen financiare të sektorëve institucionalë. Ndërtimi dhe interpretimi i tij paraqitet në shënimin në vijim.



Në dimensionin e ekspozimit neto, ekonomitë familjare dhe sektori jorezident pozicionohen në kreditorë ose huadhënës neto, ndërkohë që, korporatat

⁴ Për më gjerësisht, shpjegimi në botimin e Bankës së Shqipërisë “Statistikat e llogarive financiare për vitin 2017” dhjetor 2018, në seksionin metodologjik 1.5 Matrica ‘nga kush - tek kush’ dhe rrjedha e fondeve.

jofinanciare dhe qeveria e përgjithshme vijojnë në pozicion debitor ose huamarrës neto⁵. Për shkak të natyrës së biznesit, korporatat financiare shfaqin një pozicion neto shumë të ulët, afër zeros.

Spektori financiar, sektori korporata jofinanciare dhe ai jorezident evidentohen si sektorët kryesorë për sa i përket ekspozimit bruto⁶ (vektorët më të theksuar).

Gjithashtu, shkalla e integritit me jashtë (segmenti lidhës me sektorin jorezident) paraqitet e lartë për korporatat financiare - me një total të ekspozimit bruto prej 1,137 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve në letra me vlerë, marrëdhënieve interbankare, depozitave të emigrantëve, si dhe pjesëmarrjes së huaj të kapitalit në sektorin bankar. I ilustruar me të dhënat në paraqitjen e llogarive financiare sipas matricës 'nga kush – tek kush', ekspozimi bruto i sektorit të korporatave financiare me jashtë (jorezidentët) përlllogaritet si shumator i mjeteve (801) dhe detyrimeve (335) të korporatave financiare me jorezidentët (Tabela 2).

Tabelë 2. Paraqitja e llogarive financiare në matricën 'nga kush – tek kush' - viti 2019, në miliardë lekë.

		Sektori Kreditor				
		Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare	Jorezidentët
Sektori debitor	Korporatat jofinanciare	521	384	489	668	1,007
	Korporatat financiare	290	252	96	1,199	335
	Qeveria e përgjithshme	300	498	n/a	79	459
	Ekonomitë familjare	7	230	-	n/a	-
	Jorezidentët	121	801	-	56	n/a

Burimi: BSH

Për korporatat jofinanciare totali i ekspozimit bruto me jashtë vlerësohet 1,127 miliardë lekë, dhe vjen kryesisht si pasojë e pjesëmarrjes në kapital të në formën e investimeve të huaja direkte.

Qeveria e përgjithshme ka një vlerë të ekspozimit bruto me jashtë prej 459 miliardë lekësh, rrjedhojë e nivelit të lartë të financimit të huaj në borxhin e qeverisë.

Financimi brenda sektorit – si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje ndaj ekspozimit total bruto – vërehet më i lartë në sektorin e korporatave jofinanciare (në nivelin 521 miliardë lekë).

⁵ Më gjerësisht, analiza e zhvillimeve të llogarive financiare për çdo sektor në seksionin 4.

⁶ Totali i mjeteve dhe detyrimeve financiare me sektorë të tjerë.

4 ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALE⁷


EKONOMITË FAMILJARE⁷

Ekonomitë familjare, zotërojnë rreth 33% të totalit të mjeteve financiare të brendshme. Në harkun kohor një viti, mjetet e këtij sektori u zgjeruan me rreth 98 miliardë lekë dhe në fund të 2019 shënojnë 2,002 miliardë lekë.


Mjetet financiare të ekonomive familjare, tejkalojnë ndjeshëm detyrimet e këtij sektori. Instrumenti kryesor i përdorur nga ekonomitë familjare, vijon të jetë “monedha dhe depozitat”, i cili përfaqëson 54% të mjeteve financiare të këtij sektori, në fund të 2019. Ndërkohë “kapitali dhe aksione në fonde investimi” përbën 35% të totalit të mjeteve financiare, ndjekur nga “letra me vlerë të borxhit” 4% dhe në masë më të vogël pretendimet në “sigurime dhe skemat pensione” 0.2%.

Zgjerimi vjetor në mjete financiare të këtij sektori i atribuohet në masën me të madhe rritjes së investimeve në “monedha dhe depozitat” prej 63 miliardë lekë, ndjekur nga zgjerimi i “llogari të tjera të arkëtueshme” prej 27 miliardë


Grafik 3. Mjete financiare të ekonomive familjare




Grafik 4. Mjete financiare të ekonomive familjare: ndryshimi i stokut



Grafik 5. Përbërja e mjeteve financiare të ekonomive familjare, 2019



Grafik 6. Përbërja e detyrimeve të ekonomive familjare, 2019



Burimi: BSH

⁷ Përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve (NPISH), të tilla si organizatat e ndihmës sociale, kishat, sindikatat, partitë politike dhe klubet argëtuese, të cilat u ofrojnë familjeve shërbime jo-tregu. Mjetet dhe detyrimet financiare të NPISH vlerësohen në më pak se 1% të totalit të aktiveve financiare dhe detyrimeve të ekonomisë familjare. Kur interpretohen të dhënat për mjetet financiare të këtij sektori duhet të konsiderojmë se të dhënat ekonomike janë në nivel të agreguar. Llogaritë financiare nuk disponojnë informacion në lidhje me mjetet financiare individuale të familjeve apo shpërndarjen e pasurisë brenda sektorit.

lekë, dhe “kapitali dhe aksione në fonde investimi” me rreth 18 miliardë lekë. Ndërkohë, zotërimet në “letra me vlerë” ranë me rreth 10 miliardë lekë.

Tabelë 3. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të ekonomive familjare, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mjete financiare							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	915	938	955	984	996	1,022	1,085
Letra me vlerë të borxhit	72	76	83	80	92	96	86
Hua	4	5	2	2	3	3	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	569	569	668	614	568	681	699
Sigurime dhe skemat e pensioneve	1	2	2	3	3	4	5
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të arkëtueshme	114	176	80	99	101	98	125
Totali	1,675	1,767	1,792	1,781	1,764	1,904	2,002
Detyrime							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-
Hua	165	167	176	183	195	207	224
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të pagueshme	27	23	24	11	11	12	12
Totali	192	190	200	194	206	218	236

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


.. Mungon informacioni

Burimi: BSH


Detyrimet e ekonomive familjare përbëhen kryesisht nga kreditë hipotekore, të cilat zënë peshën më të madhe të totalit, ndjekur nga kreditë konsumatore dhe huatë e tjera. Në një total prej 224 miliardë lekë detyrimi në “hua” të këtij sektori në fund të vitit 2019, kredia hipotekore përbën rreth 52%.

Detyrimi në “hua” i ekonomive familjare, referuar fundvitit 2018 u zgjerua me +17.4 miliardë lekë. Transaksioni (fluksi) në “hua”, pastruar për efekt të kursit të këmbimit dhe ndryshime të treja, gjatë vitit 2019 shënon një zgjerim prej +18.1 miliardë lekë. Detyrimi në “hua” ndaj sektorit të korporatave depozituese përveç bankës qendrore (bankave të nivelit të dytë) u rrit me 12.2 miliardë lekë në nivelin e 194 miliardë lekë, ndërsa “huatë” me institucionet e tjera financiare u zgjeruan me 3 miliardë lekë, në nivelin e 28 miliardë lekë.


Grafik 7. Detyrime të ekonomive familjare: hua



Grafik 8. Detyrimet, hua: ndarja sipas qëllimit të huasë, 2019



Grafik 9. Detyrimet e ekonomive familjare: ndryshimi i stokut të huasë



Burimi: BSH

KORPORATAT JOFINANCIARE


Detyrimet e korporatave jo-financiare (ose ndryshe bizneset) janë dukshëm në nivel shumë më të lartë se mjetet e tyre. Kjo, për arsye se mjetet jo-financiare nuk raportohen në anën e mjeteve financiare të llogarive financiare. Për më tepër, krahas huave dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë edhe aksionet e emetuara nga korporatat.

Në fund të vitit 2019, biznesi ose korporatat jo-financiare zotërojnë rreth 1,238 miliardë lekë mjete financiare, shifër e cila përbën rreth 21% të totalit të mjeteve të brendshme financiare.

Në masën 21% mjetet financiare të korporatave jo-financiare janë në "monedha dhe depozitat", ndjekur nga "aksione dhe kapital tjetër" 7% dhe "hua" 5.5%. Zotërimet në "sigurime dhe skemat e pensione" dhe "letrave me vlerë të borxhit" së bashku përbëjnë vetëm 3.9% të aktiveve financiare. Instrumenti "llogari të tjera të arkëtueshme" është vlerësuar në rreth 63% të totalit të aktiveve financiare të korporatave jo-financiare. Ky zë krahas kredive tregtare, regjistron edhe pretendime të tjera përkundrejt sektorëve të lidhur.

Investimet e sektorit në "monedha dhe depozita" u rritën 4 miliardë lekë në nivelin 258 miliardë lekë në fund të 2019, ku zgjerimi më i madh u verejt në vendosjet e depozitave jashtë vendit (në bankat jorezidente). Mjetet financiare në formën e "huasë" u tkurrën me 1.3 miliardë lekë, në nivelin e 68 miliardë lekë: huadhënia brenda sektorit u zgjerua lehtësisht me 3.8 miliardë lekë ndërkohë që, huadhënia ndaj palëve të treta, kryesisht sektorëve jorezidentë,

ra me 5.1 miliardë lekë. Investimet në “aksione dhe kapital tjetër” u rritën me 6 miliardë lekë në nivelin 84 miliardë lekë. Investimet në “letra me vlerë të borxhit” u rritën në drejtim të zgjerimit të investimit në tituj të qeverisë shqiptare.



Tabelë 4. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave jofinanciare, në miliardë lekë.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mjete financiare							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	143	177	186	247	275	254	258
Letra me vlerë të borxhit	-	57	62	61	47	26	28
Hua	187	73	66	65	57	69	68
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	59	58	40	63	68	78	84
Sigurime dhe skemat e pensioneve	7	9	10	14	14	14	20
Derivativë financiarë	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	666	699	672	629	612	600	780
Totali	1,063	1,073	1,036	1,078	1,073	1,042	1,238
Detyrime							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	47	48	37	39	39	35	33
Hua	764	741	704	704	687	659	679
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	975	987	1,083	1,118	1,221	1,380	1,467
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të pagueshme	812	942	815	794	735	780	890
Totali	2,598	2,718	2,639	2,653	2,681	2,854	3,069

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


.. Mungon informacioni

Burimi: BSH

Në fund të vitit 2019, struktura e detyrimeve të korporatave jofinanciare paraqiten si në vijim: “aksione dhe kapital tjetër” (48%), “llogari të tjera të pagueshme” (29%), “huatë” (22%) dhe “letra me vlerë të borxhit” (1%).

Detyrimet në “aksione dhe kapital tjetër” janë kryesisht me investitorët e huaj dhe ekonominë familjare, përkatësisht në masën 45% dhe 37%. Në 2019, ky zë u rrit me 87 miliardë lekë në nivelin e 1,467 miliardë lekë. Kjo rritje në masën me të madhe u diktua nga zgjerimi i pjesëmarrjes në kapital të sektorit jorezident (me 77 miliardë lekë).

Detyrimet në “hua” të korporatave jofinanciare u rritën dhë në fund të vitit 2019 shënojnë 679 miliardë lekë. Ky zhvillim i atribuohet sëbashku, zgjerimit të detyrimit të sektori ndaj korporatave të tjera depozituese (detyrimit të kredisë në sektorin bankar) me rreth 22 miliardë lekë, si dhe në masë më të vogël rritjes së detyrimit në formën e huasë brenda sektorit (hua ndërkompani), me rreth 3.8 miliardë lekë.



QEVERIA E PËRGJITHSHME


Të dhënat e sektorit të qeverisë së përgjithshme bazohen në informacionin e raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga të dhënat kundër-parti. Ky sektor paraqet të dhënat e konsoliduara për nën-sektorin e qeverisë qendrore, nën-sektorin e qeverisë lokale, fondet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve shëndetësore. Të dhënat e llogarive financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme përfshijnë kryesisht të dhënat e njërive buxhetore, kjo për të ruajtur harmonizimin me statistikën dhe të tjera të publikuara, si statistikën financiare të qeverisë (GFS) dhe llogaritë kombëtare⁸.

Mjetet financiare në zotërim të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në 585 miliardë lekë ose 10% të totalit të sektorëve të brendshëm të ekonomisë. Në terma vjetorë ato u zgjeruan me 6.7%.

Zotërimet financiare të qeverisë janë kryesisht në formën e pjesëmarrjes në “aksione dhe kapital tjetër”. Në fund të vitit 2019, këto zotërime shënojnë

⁸ Nga njësitë ekstra-buxhetore është përfshirë në të dhënat e qeverisë vetëm Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

224.7 miliardë lekë, ku rreth 190.1 miliardë lekë janë aksione/pjesëmarrje në kapital në korporata publike jofinanciare dhe rreth 33.1 miliardë lekë është kapitali i bankës qendrore (llogaritë kapitale). Kapitali i bankës qendrore në statistikat makroekonomike vlerësohet si pasuri publike, dhe regjistrohet në sektorin e qeverisë së përgjithshme. Mjetet financiare në formën e “monedha dhe depozita”, gjatë 2019 ranë me 20.7 miliardë lekë në nivelin 57 miliardë lekë. Rënia u ndikua nga rënia e depozitave të transferueshme në bankën qendrore.



Tabelë 5. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të qeverisë së përgjithshme, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mjete financiare							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	28	23	37	34	48	78	57
Letra me vlerë të borxhit	0	0	0	0	0	0	0
Hua	58	59	36	42	49	58	59
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	226	215	237	238	237	217	225
Sigurime dhe skemat e pensioneve
Derivatë financiare	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	169	166	218	224	172	196	245
Totali	482	464	528	538	506	548	585
Detyrime							
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	542	569	557	562	583	628	640
Hua	292	343	406	422	434	407	399
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-
Derivatë financiare	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të pagueshme	140	118	179	203	190	160	297
Totali	974	1,031	1,142	1,187	1,207	1,195	1,335

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni


Burimi: BSH

Në fund të vitit 2019, detyrimet e qeverisë së përgjithshme vlerësohen në nivelin 1,335 miliardë lekë. Mëse gjysma e detyrimeve (48%) përbëhet nga "letrat me vlerë të borxhit". Stoku i "letrave me vlerë të qeverisë" përlogaritet në rreth 640 miliardë lekë⁹ nga 628 miliardë në fund të 2018. Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i jorezidentëve, i cili mban rreth 44% të totalit, pasuar nga sektori i korporatave të tjera depozituese (bankat) në rreth 37%. Detyrimet në llogari të tjera të pagueshme të qeverisë së përgjithshme për vitin 2019 u vlerësuan në rreth 296.5 miliardë lekë¹⁰.

Grafik 20. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: letra me vlerë



Grafik 21. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: ndryshimi i stokut të letrave me vlerë



Burimi: BSH

KORPORATAT FINANCIARE

Mjetet financiare të korporatave financiare në fund të vitit 2019 shënojnë 2,165 miliardë lekë dhe përfaqësojnë në masën 36% totalin e mjeteve të brendshme financiare të Shqipërisë.

Sektori i korporatave financiare¹¹ përbëhet nga nënsektorët nga banka qendrore (23%), korporata depozituese përveç bankës qendrore (69%), fondet e investimit (3%), shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit (2%) dhe institucionet e tjera financiare (3%)..

Në masën më të madhe zotërimet financiare të sektorit të korporatave financiare janë në formën e investimeve në "letra me vlerë të borxhit", me rreth 38% të totalit të mjeteve financiare në fund të vitit 2019. Zotërimet në "hua" dhe "monedha e depozita", gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të mjeteve financiare të këtij sektori, përkatësisht më 32% dhe 26%.

Në krahun e detyrimeve, instrumenti kryesor është "monedha e depozita", në

⁹ Në mungesë të informacionit mbi vlerën e tregut, vlera e stokut të letrave me vlerë të qeverisë së përgjithshme për letrat me vlerë të tregtuara në tregun e brendshëm është vlerësuar në vlerë nominale (cmimi i emetimit plus interesat e përlogaritur) si një përafrim më i saktë i vlerësimit për vlerën e tregut të këtij instrumenti.


¹⁰ Për më shumë mbi vlerësimet e të dhënave të qeverisë sw pwr gjithshme nw kw tv instrument financiar shiko dokumentin metadata.

¹¹ Lista e detajuar gjendet nw lidhjen https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Lista_Nensektoret_e_korporatat_financiare_ESA_2010_PUBLIKIM_2018_13470.xlsx


rreth 79% të totalit. Detyrimet në "kapital e aksione në fonde investimi" zënë 13% të totalit të detyrimeve të korporatave financiare.

Nënsektori i korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) është dominues në performacën e të gjithë sektorit financiar. Ai zë mesatarisht 69% të totalit të mjeteve të sektorit dhe 24% të totalit të ekonomisë vendase. "Hua" dhe "letrat me vlerë të borxhit" janë instrumentat që dominojnë mjetet financiare të sektorit bankar, dhe në masë me të vogël "monedha dhe depozita". Për nënsektorin e ndërmjetësve të tjerë financiarë, instrumentat financiarë më të rëndësishëm, si në mjete dhe në detyrime janë "huaja" dhe "kapitali dhe aksione në fonde investimi".


Grafik 22. Mjete financiare të korporatave financiare – instrumentat kryesore




Grafik 23. Detyrime të korporatave financiare – instrumentat kryesore



Grafik 24. Përbërja e mjeteve financiare të korporatave financiare, 2019



Grafik 25. Përbërja e detyrimeve të korporatave financiare, 2019



Burimi: BSH

Tabelë 7. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave financiare, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mjete financiare							
Ari monetar dhe SDR	17	19	31	27	26	20	24
Monedha dhe depozita	317	328	445	461	541	579	558
Letra me vlerë të borxhit	749	809	768	802	744	763	827
Hua	635	663	649	696	702	658	687
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	14	14	19	22	28	30	34
Sigurime dhe skemat e pensioneve	4	4	5	5	5	5	9
Derivatë financiare	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	17	16	16	23	26	26	27
Totali	1,753	1,853	1,933	2,036	2,073	2,081	2,166
Detyrime							
Ari monetar dhe SDR	7	8	8	8	7	7	7
Monedha dhe depozita	1,363	1,430	1,508	1,580	1,629	1,669	1,721
Letra me vlerë të borxhit	0	0	6	6	7	7	8
Hua	76	81	58	77	86	81	97
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	226	258	283	293	295	277	292
Sigurime dhe skemat e pensioneve	10	12	16	18	19	20	26
Derivatë financiare	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	23	18	21	18	16	20	22
Totali	1,706	1,807	1,901	2,000	2,060	2,080	2,173

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: BSH

Tabelë 8. Mjete financiare dhe detyrimeve të nënsektorëve të korporatave financiare, 2019, në miliardë lekë

	Banka Qendrore	Korporata të tjera depozituese	Fondet e investimit	Ndërmjetësit e tjerë financiarë	Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit
Mjete financiare					
Ari monetar dhe SDR	24	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	152	372	4	18	12
Letra me vlerë të borxhit	284	479	58	0	6
Hua	36	612	3	35	0
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	0	13	3	15	3
Sigurime dhe skemat e pensioneve	5
Derivatë financiare	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	5	10	0	6	6
Totali	501	1,486	68	74	37
Detyrime					
Ari monetar dhe SDR	7	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	481	1,240	-	0	-
Letra me vlerë të borxhit	-	8	-	0	-
Hua	0	59	-	37	1
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	33	157	68	23	11
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	26
Derivatë financiare	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	1	11	0	6	3
Totali	522	1,475	68	67	41

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: BSH

KORPORATA DEPOZITUESE PËRVEÇ BANKËS QENDRORE


Mjetet financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) u zgjeruan me 72.8 miliardë lekë dhe në fund të vitit 2019 shënojnë 1,486 miliardë lekë.

Instrumenti financiar “hua” mban pjesën më të madhe të mjeteve financiare të këtij nënsektori, me përafërsisht 41% të totalit. Gjatë 2019, këto zotërime u rritën me 19 miliardë lekë në nivelin 612 miliardë lekë. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga zgjerimi i huasë akorduar sektorit të korporatave jofinanciare me 21.6 miliardë lekë dhe sektorit të ekonomive familjare me rreth 12.2 miliardë lekë. Ndërkohë, kredia akorduar sektorit jorezident ra në terma nominalë me 17.3 miliardë lekë dhe në fund të 2019 përfaqëson rreth 6% të portofolit të kredisë bankare nga 9% që shënonte në fund të vitit 2018.


Portofoli në “letra me vlerë të borxhit” i cili përfaqëson rreth 32% të mjeteve financiare të sektorit banka, u zgjerua me 38.7 miliardë lekë ose 9% në terma vjetorë. Në fund të vitit 2019, temrica në “letra me vlerë të borxhit” shënon 479 miliardë lekë. Investimet në letra me vlerë afatgjata të jorezidentëve mbeten atraktive dhe gjatë vitit u rritën me rreth 19% , duke zgjeruar peshën e tyre në totalin e letrave me vlerë në nivelin 21%.

Në krahun e detyrimeve, “monedha dhe depozita” përbëjnë komponentin kryesor të emetimit të detyrimeve financiare të sektorit bankar, në masën 84% të totalit në fund të vitit 2019. Depozitat bankare gjatë këtij viti, u zgjeruan me 63 miliardë lekë, në nivelin 1,234 miliardë lekë. Ky zhvillim është pasojë e zgjerimit të bazës së depozitave të sektorit të brendshëm të ekonomisë.

Grafik 26. Mjete financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore – instrumentat kryesore



Grafik 27. Detyrime të korporatave depozituese përveç bankës qendrore – instrumentat kryesore




Burimi: BSH

FONDET E INVESTIMEVE

Gjatë vitit 2019, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde investimi, ku një fond i ri investimi i është bashkuar këtij tregu në fund të vitit.

Në fund të vitit 2019, mjetet financiare të fondeve të investimeve shënojnë 68 miliardë lekë dhe gjatë vitit u rritën lehtësisht me 1%. Ecuria e këtij tregu mbetet nën ndikimin e një ambienti me norma të ulëta të interesit. Në të njëjtën kohë, ecuria e kursit të këmbimit ndikoi lehtësisht rënien e vlerës së asetëve të njërit prej fondeve të investimit në euro.

Në aspektin e politikës së investimeve, ato dominohen kryesisht nga investime në letra me vlerë të borxhit të qeverisë shqiptare - në masën 85%. Ky portofol investimi gjatë vitit u zgjerua në terma vjetorë me rreth 4%, dhe në fund të 2019 shënon vlerën 58 miliardë lekë. Letra me vlerë të borxhit afatgjatë vlerësohen në nivelin 47.4 miliardë lekë.



Nga ana e detyrimeve, në konsiderata të llojit të ndërmjetësimit financiar që kryhet nga fondet e investimeve, detyrimi kryesor financiar i këtij nënsektori është në kuota (njësi) të fondit të investimit, të cilat përbëjnë 99% të detyrimeve financiare, në fund të vitit 2019. Në terma absolutë, stoku i këtij instrumenti u rrit gjatë vitit me 4% pas një rënieje prej 10% të shënuar në vitin 2018. Investitorë në fondet e investimeve janë individët.

KOMPANITË E SIGURIMIT DHE FONDET E PENSIONIT

Tregu shqiptar i sigurimeve vijon me një rritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi. Gjatë vitit 2019 filloi aktivitetin një kompani e re sigurimi duke e çuar në 12 numrin e shoqërive operuese në tregun e sigurimeve.

Për vitin 2019, mjetet financiare të kompanive të sigurimit dhe ato të fondeve të pensionit shënuan në total 36.8 miliardë lekë, në zgjerim vjetor me rreth 26%. Së bashku, këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm 1.7% në totalin e mjeteve të korporatave financiare.

“Monedha dhe depozita”, si dhe “letra me vlerë të borxhit” janë dy instrumentet më të rëndësishëm financiar të mbajtur nga këta nënsektorë. Në fund të 2019,

teprica në “monedha dhe depozita” shënoi 12 miliardë lekë dhe vlerësohet lehtësisht në rritje.

Në krahun e detyrimeve, rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor janë detyrimet kryesore financiare të nënsektorit të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit. Në fund të vitit 2019, teprica e këtyre detyrimeve shënon 26 miliardë lekë dhe përbën 63% të totalit të detyrimeve financiare. Peshën kryesore të këtij detyrimi e përbëjnë rezervat e sigurimit të jo-jetës, me 82% të totalit.

Aksione ose njësi të fondeve të investimit ose llogaria e kapitaleve të veta, është një tjetër instrument i rëndësishëm financiar në totalin e detyrimeve financiare të këtij nënsektori (me rreth 27%).

